



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI I FILOLOGJISË

Rr. Xhorxh Bush, nr. 31, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383-38-222970 • E-mail: filologjia@uni-pr.edu • www.filologjia.uni-pr.edu

Këshilli i Fakultetit të Filologjisë

Nr. Prot.: 01/ 2350

Data: 14/7/2026

Këshilli i Fakultetit të Filologjisë në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 14.7.2026, shqyrtoi raportin e komisionit të ankesave ne Nr. Prot.: 03/2264 dt.08.07.2026, sipas nenit 8 të Rregullores me Nr.Prot.: 2/254, dt. 17/7/2024 lidhur me pozitën III.1 të Fakultetit të Filologjisë, mori:

VENDIM

- I. **REFUZOHET SI E PA BAZUAR** ankesa e z. Nuhi Bllaca (më poshtë parashtues i ankesës) me Nr.Prot.: 04/2114 dt. 26.6.2026 e parashtuar brenda afatit ligjor sipas njoftimit zyrtar me rastin e publikimit të raportit të komisionit vlerësues me Nr.Prot.: 03/2059, dt. 22.6.2026, parashtuesi i ankesës është kandidat i paraqitur në Thirrjen publike 1/746, dt. 29.5.2026 për angazhimin e profesorëve dhe asistentëve të angazhuar për ligjërata dhe ushtrime, respektivisht pozitën III.1 për lëndët: Hyrje në mësimdhënie dhe mësimnxënie (BA), Testimi dhe vlerësimi (BA), Hyrje në mësimdhënie dhe mësimnxënie (BA), Planifikimi i orës mësimore (BA), Mësimdhënia e anglishtes për grupmoshat e reja (BA).
- II. **VËRTETOHET** propozimi i komisionit vlerësues lidhur vlerësimin për pozitën III.1. të thirrjes së lartpërmendur me Nr.Prot.: 03/2059 dt. 22.6.2026.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

Arsyetim

Këshilli i Fakultetit të Filologjisë, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më datë 14.7.2026, ka shqyrtuar raportin e Komisionit të Ankesave me Nr. Prot.: 03/2264 dt.08.07.2026. Ky raport trajton ankesën e z. Nuhi Bllaca lidhur me raportin e Komisionit Vlerësues për vlerësimin e pozitës III.1 në kuadër të Thirrjes Publike me 1/746, dt. 29.5.2026, për angazhimin e profesorëve dhe asistentëve për ligjërata dhe ushtrime. Komisioni i Ankesave pas shqyrtimit të ankesës, raportit të komisionit vlerësues dhe dokumentacionit të kandidatëve, konstatoi se pretendimet e ankuesit lidhur me publikimet shkencore, pjesëmarrjen në konferenca shkencore, trajnimet profesionale dhe përvojën e punës janë trajtuar në mënyrë të plotë, të individualizuar dhe të arsyetuar nga komisioni vlerësues, në përputhje me kërkesat e konkursit dhe dispozitat e Rregullores nr. 2/254. Nga raporti vlerësues rezulton se vlerësimi nuk është mbështetur në një krahasim mekanik të numrit të publikimeve, konferencave apo aktiviteteve profesionale, por në një analizë të përgjithshme të

profilin akademik dhe profesional të secilit kandidat, duke vlerësuar relevancën dhe përputhshmërinë e tyre me natyrën e lëndëve dhe nevojat konkrete të pozitës së shpallur. Në këto rrethana, pretendimet e ankuesit nga pika 2 deri në 5 përbëjnë mospajtim me rezultatin e vlerësimit profesional të Komisionit Vlerësues dhe jo prova të ndonjë shkeljeje të dispozitave të konkursit apo të Rregullores nr. 2/254. Ankuesi nuk ka paraqitur fakte, prova apo rrethana të reja që do të vinin në dyshim ligjshmërinë e procedurës, objektivitetin e vlerësimit ose zbatimin e kritereve të konkursit. Për rrjedhojë, nuk ekziston asnjë bazë faktike apo juridike që do të justifikonte ndërhyrjen në diskrecionin profesional të Komisionit Vlerësues.

Ndërlidhur me fushat e studimit të doktoratës të dy kandidatët posedojnë kualifikime të avancuara akademike dhe përvojë në arsimin e lartë. Megjithatë, vlerësimi i komisionit është bazuar në shkallën e përputhshmërisë së profilin akademik dhe profesional me kërkesat konkrete të pozitës dhe me nevojat aktuale të Departamentit.

Parashtruesi i ankesës ka përfunduar studimet Master dhe doktoratën në fushën e English and American Studies, me elemente të gjuhësisë së aplikuar dhe mësimin të gjuhës angleze. Ndërsa ky profil është i rëndësishëm dhe i vlefshëm akademikisht, specializimi i tij nuk është i orientuar në mënyrë specifike drejt metodologjisë së mësimdhënies së gjuhës angleze (TESOL), didaktikës së përgatitjes së mësimdhënësve dhe mësimdhënies për grupmoshat e reja, të cilat përbëjnë komponentë thelbësorë të lëndëve për të cilat është shpallur konkursi.

Në anën tjetër, kandidatja e propozuar posedon një profil që i përgjigjet drejtpërdrejt nevojave të pozitës. Studimet Master në TESOL përfaqësojnë një specializim të dedikuar në metodologjinë e mësimdhënies së gjuhës angleze, ndërsa doktorata e saj në fushën e arsimit e plotëson këtë profil me ekspertizë në praktikën bashkëkohore të mësimdhënies. Veçanërisht me rëndësi është fakti se ajo ka ndjekur trajnim të specializuar për mësimdhënien e gjuhës angleze për grupmoshat e reja, kompetencë që lidhet drejtpërdrejt me lëndën *Mësimi i gjuhës angleze për grupmoshat e reja*.

Kjo lëndë është pjesë e programit të Departamentit të Gjuhës dhe letërsisë angleze, por nuk ka mundur të ofrohet në mënyrë të rregullt për shkak të mungesës së një profili me ekspertizë specifike në këtë fushë. Si rrjedhojë, përzgjedhja e një kandidati me formim të specializuar në TESOL dhe në mësimdhënien e gjuhës angleze për grupmoshat e reja adreson një nevojë konkrete akademike të Departamentit dhe kontribuon drejtpërdrejt në përmirësimin e përgatitjes profesionale të mësimdhënësve të ardhshëm të gjuhës angleze.

Gjithashtu, kandidatja e propozuar ka përvojë të drejtpërdrejtë në mësimdhënie në Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze të Universitetit të Prishtinës, duke ligjëruar në programin për të cilin shpallet kjo pozitë. Kjo përvojë i ka mundësuar njohje të thelluar të objektivave të programit, rezultateve të të nxënit dhe kompetencave që kërkohen për përgatitjen e mësimdhënësve të ardhshëm të gjuhës angleze, duke e bërë atë të gatshme për t'iu përgjigjur menjëherë kërkesave të kësaj pozite.

Për këto arsye, Këshilli i Fakultetit të Filologjisë vlerëson se kandidatja e propozuar paraqet profilin më të përshtatshëm për realizimin e lëndëve të shpallura, bazuar në relevancën e specializimit, përvojës dhe kompetencave të saj profesionale me kërkesat konkrete të pozitës, dhe jo në një vlerësim të përgjithshëm të meritave akademike të kandidatëve.

Bazuar në këtë, Këshilli i Fakultetit të Filologjisë, në mbledhjen jashtëzakonshme më datë 14.7.2026, ka shqyrtuar raportin e Komisionit të Ankesave dhe konkludon se, gjatë vlerësimit, janë marrë për bazë dhe janë respektuar në tërësi dispozitat e Rregullores me Nr. Prot.: 2/254, datë 17.07.2024, të cilat përcaktojnë kushtet dhe kriteret për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm.

Bashkëngjitur vendimit është raporti i komisionit të ankesave me Nr.Prot.: 03/2264, dt. 08.7.2026.

Duke u bazuar në këtë u vendos si në dispozitiv të vendimit.

Këshillë juridike: *Pala e pakënaqur me këtë vendim, mund të iniciojë kontest në gjykatën kompetente, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga njoftimi i vendimit.*

Vendimi t'u dërgohet:

- Arkivit të Fakultetit të Filologjisë,
- Dekanatit të Fakultetit të Filologjisë,
- Sekretarit të Fakultetit të Filologjisë,
- Parashtruesit të ankesës z. Nuhi Bllaca

DEKAN
Prof.asoc. Abdulla Rexhepi





UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I FILOLOGJISË

Rr. Xhorxh Bush nr. 31 10000 Prishtinë Republika e Kosovës
Tel: +383-38-222970 • E-mail: filologjia@uni-pr.edu • www.filologjia.uni-pr.edu

Nr. prot: 03/2264
Datë: 8/7/2026

KOMISIONI I ANKESAVE PËR PROFESOR DHE ASISTENT TË ANGAZHUAR I
FAKULTETIT TË FILOLOGJISË

nxjerr këtë:

RAPORT

Kandidati: Nuhi Bllaca
Ankesa: Nr. prot. 04/2114 datë 26.6.2026
Pozita: Profesor i angazhuar pika III.1 sipas konkursit të datës 29.5.2026

Komisioni për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve për thirrjet profesor dhe asistent i angazhuar i emëruar sipas vendimit të Dekanit të Fakultetit të Filologjisë nr. prot. 01/2072 datë 22.06.2026 në përputhje me Statutin e Universitetit të Prishtinës dhe Rregulloren për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës nr. prot. 2/254 datë 17.07.2024 e ka shqyrtuar ankesën e kandidatit Nuhi Bllaca nr. prot. 04/2114 datë 26.06.2026 kundër raportit të Komisionit Vlerësues nr. prot. 03/2059 datë 22.06.2026 për angazhimin e profesorit të angazhuar për ligjërata pika III.1 sipas konkursit të shpallur më 29.05.2026.

Pas analizimit të dokumentacionit përkatës përfshirë raportin e Komisionit Vlerësues dokumentacionin elektronik të kandidatëve dhe pretendimet e paraqitura në ankesë Komisioni i Ankesave paraqet këto gjetje dhe konstatime:

Lidhur me pretendimin e parë

Sa i përket pretendimit se kandidatja e propozuar nuk posedon doktoraturë në fushën për të cilën janë shpallur lëndët e konkursit dhe se për këtë arsye nuk plotëson kriterin e përcaktuar në Rregullore për t'i dhënë përparësi kandidatëve me gradë shkencore në lëminë përkatëse Komisioni i Ankesave vlerëson se ky pretendim nuk lidhet me mënyrën e vlerësimit të kandidatëve nga Komisioni Vlerësues por me përcaktimin e fushës akademike të lëndëve të shpallura në konkurs e cila është kompetencë e njësisë akademike. Në përputhje me pargafin 3 dhe 4 nenin 5 të Rregullores nr. 2/254 shpallja e konkursit bëhet mbi bazën e propozimit të njësisë akademike e cila përcakton nevojat për angazhim dhe fushën përkatëse të lëndëve. Për rrjedhojë vlerësimi nëse fusha e doktoraturës së kandidatit të propozuar përputhet me fushën e lëndëve të shpallura nuk

është çështje që mund të zgjidhet nga Komisioni i Ankesave përmes rivlerësimit të dokumentacionit të kandidatëve por duhet të trajtohet nga Këshilli i Fakultetit i cili sipas nenit 8 të Rregullores është organi që shqyrton raportin e Komisionit Vlerësues dhe raportin e Komisionit të Ankesave para marrjes së vendimit përfundimtar. Për këtë arsye Komisioni i Ankesave konsideron se para vendimmarrjes përfundimtare Këshilli i Fakultetit duhet të qartësojë nëse fusha akademike e kandidatit të propozuar përputhet me fushën e lëndëve të shpallura në konkurs dhe këtë vlerësim ta pasqyrojë në arsyetimin e vendimit të tij.

Lidhur me pretendimet e paraqitura në pikat 2 deri në 5 të ankesës

Sa i përket pretendimeve lidhur me publikimet shkencore konferencat shkencore trajnimet profesionale dhe përvojën e punës Komisioni i Ankesave konstaton se këto çështje janë trajtuar në mënyrë të detajuar dhe të argumentuar në raportin nr. prot. 03/2059 datë 22.06.2026 të Komisionit Vlerësues. Nga shqyrtimi i raportit rezulton se Komisioni Vlerësues ka analizuar individualisht dokumentacionin e secilit kandidat duke marrë në konsideratë publikimet shkencore përvojën në arsimin e lartë trajnimet profesionale konferencat shkencore dhe elementet tjera të dokumentacionit të dorëzuar, raporti nuk është mbështetur vetëm në numrin e publikimeve apo të aktiviteteve profesionale por ka bërë një vlerësim të përgjithshëm të profilit akademik dhe profesional të kandidatëve në raport me nevojat konkrete të pozitës së shpallur. Pretendimet e ankuesit se posedon numër më të madh publikimesh pjesëmarrje më të madhe në konferenca më shumë trajnime profesionale dhe përvojë më të gjatë pune nuk dëshmojnë në vetvete se Komisioni Vlerësues ka vepruar në kundërshtim me konkursin ose me dispozitat e Rregullores nr. 2/254. Përkundrazi nga raporti vlerësues rezulton se këto elemente janë shqyrtuar dhe janë marrë në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit mirëpo Komisioni Vlerësues në ushtrimin e kompetencës së tij profesionale ka arritur në përfundimin se profili akademik dhe profesional i kandidates së propozuar paraqet përputhshmëri më të madhe me natyrën e lëndëve të shpallura në konkurs.

Komisioni i Ankesave vlerëson se, në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të paraqitura në pikat 2 deri në 5 të ankesës, nuk është kompetencë e tij të zëvendësojë vlerësimin profesional të Komisionit Vlerësues me një vlerësim tjetër mbi meritat relative të kandidatëve pas shqyrtimit të raportit vlerësues dhe dokumentacionit të kandidatëve rezulton se këto pretendime janë trajtuar dhe arsyetuar nga Komisioni Vlerësues, i cili ka bërë vlerësimin e tyre në funksion të profilit të kandidatëve dhe nevojave të pozitës së shpallur.

Në rastin konkret, pretendimet e ngritura në pikat 2 deri në 5 të ankesës paraqesin kryesisht mospajtim me mënyrën e vlerësimit profesional të Komisionit Vlerësues dhe nuk përmbajnë fakte apo prova të reja që do të arsyetonin ndërhyrjen e Komisionit të Ankesave në këtë pjesë të raportit. Ky vlerësim nuk paragjykon çështjen e ngritur në pretendimin e parë të ankesës, e cila, për shkak të natyrës së saj, duhet të trajtohet veçmas nga Këshilli i Fakultetit para marrjes së vendimit përfundimtar

Përfundim

Komisioni i Ankesave konstaton se për sa i përket pretendimeve të paraqitura në pikat 2 deri në 5 të ankesës Komisioni Vlerësues ka vepruar në përputhje me kërkesat e konkursit dhe dispozitat e Rregullores nr. 2/254 duke arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme vlerësimin e bërë për kandidatët. Ndërkaq lidhur me pretendimin e parë Komisioni i Ankesave vlerëson se çështja e përputhshmërisë së fushës akademike të kandidatit të propozuar me lëndët e shpallura në konkurs është çështje që duhet të shqyrtohet dhe të qartësohet nga Këshilli i Fakultetit para marrjes së vendimit përfundimtar duke qenë se përcaktimi i fushës së lëndëve dhe nevojave akademike është përgjegjësi e njësisë akademike që ka propozuar shpalljen e konkursit.

Për rrjedhojë Komisioni i Ankesave i rekomandon Këshillit të Fakultetit që para vendimmarrjes përfundimtare të shqyrtojë dhe të qartësojë këtë çështje ndërsa për pjesën tjetër të pretendimeve të ankuesit të konstatojë se ato janë të pabazuara

.Prishtinë më 8.7.2026

Komisioni i ankesave:

Prof. asoc. Muhamed Çitaku (kryetar)

Prof. asoc. Zeqije Xhafçe (anëtare)

Prof. asst. Ardita Berisha (anëtare)